

**Naser (Ahmet) Kodra**

(14.03.1961, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, student, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Naseri e studionte gjuhën dhe letërsinë shqipe. Forcat serbe e ndërmorën më **24.09.1998** një sulm kundër fshatrave në komunën e Skënderajt/Srbica. Popullata u zhvendos nëpër pyjet, ndërkaq në fshat ndenjën vetëm pjesëtarë të UÇK-së. Naseri ka rënë në luftimet me forcat serbe në fshatin **Dashec/Doševac**. Ushtarët serbë e kanë vendosur trupin e Naserit mbi një tank dhe e kanë çuar në Skënderajt/Srbica. Trupi i Naserit ka qëndruar për 24 orë mbi tankun e parkuar pranë stacionit policor. Të nesërmen, ushtarët shkuan me tankun dhe trupin e Naserit në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Pas dy javësh, familjarët kanë mësuar nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica se Naserin e kishin varrosur në varrezat myslimane në Zveçan/Zvečan. Katër vjet më vonë, ekspertët për mjekësinë ligjore të Zyrës së UNMIK-ut për Persona të Zhdukur i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Naserit për shkak të identifikimit të tij. Pastaj, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Naserit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Polac/Poljance.

**Burimet:** deklarata A.K, FDH-31866; J. Martinzen, *Regjistr...*, FDH-26092.

**Naim (Kadri) Salihu**

(20.01.1973, shqiptar nga Shtutica/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac, i papunë, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Naimi me familje jetonin në Shtuticë/Štutica. Familjarët e kanë parë për herë të fundit në mëngjes më **24.09.1998**, gjatë largimit të tij nga fshati. Naimi ka rënë po atë ditë në luftimet që u zhvilluan në pyllin *Gramnik* në fshatin fqinj të **Dashecit/Doševac**. Një ditë më vonë, familjarët e kanë gjetur trupin e tij në pyll. Në mbrëmje, e kanë varrosur në varrezat e Shtuticës/Štutica. Pas lufte, në muajin tetor të vitit 1999, mbetjet mortore të Naimit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Shtuticë/Štutica.

**Burimet:** deklarata A.I, FDH-32019; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 117, FDH-23857.

**Milazim (Sinan) Behrami**

(1922, shqiptar nga Dasheci/Doševac, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, një fëmijë)

Milazimi jetonte te familja e të birit Vehbiut. Në mëngjesin e datës **24.09.1998**, Vehbiu i ka çuar fëmijët e vet në pyll dhe, pasi u siguroi një strehim, u kthye në **Dashec/Doševac** që ta merrte të atin e sëmurë. Kur arriti në periferi të fshatit, vërejt tanket që kalonin rrugës, si dhe shtëpitë të kaplaur me zjarr. Disi arriti deri te shtëpia duke u zvarritur, por nuk ka mundur ta nxirrte të atin jashtë shtëpisë së përfshirë me zjarr. Të nesërmen, me disa të afërm shkoi dhe në gërmadhat e shtëpisë i gjeti mbetjet mortore të Milazimit. E kanë varrosur po atë ditë në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata B.B, FDH-15202; ICTY, IT-05-87(M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.5D00755, FDH-33256; *Serb Offensive in Drenica Steps Up, Many Albanians Killed and Slain*, pasqyra e lajmeve, KIC, 26.09.1998, FDH-33990.

**Daut (Fazli) Avdiu**

(10.02.1939, shqiptar nga Klina e Epërme/Gornja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, dy fëmijë)

Dauti me bashkëshorten Tahiren jetonin në bashkësi familjare me dy djem dhe familjet e tyre. Nga mesi i muajit korrik të vitit 1998, forcat serbe e kanë marrë majën e kodrës *Gllavicë/Glavica* përmbi fshat dhe nga ai pozicion shtënin kohë pas kohe mbi shtëpitë e lagjes *Avdiu*. Për shkaqe sigurie, Dauti me familje kaluan te vëllai i Tahires në fshatin Lubovec/Ljubovac, ndërkaq pas tri javësh kaluan te fafesi në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica. Dy muaj më vonë [**24.09.1998**], Dauti dhe Tahirja shkuan në **Klinën e Epërme/Gornja Klina** që t'i merrnin disa rroba të dimrit dhe ushqime. Kur arritën në shtëpi, Dauti shkoi në kopsht që t'i mblidhte ca zarzavate. Në atë çast, e kanë qëlluar me armë zjarri. Ka dhënë shpirt në vend. Tahira me ndihmën e kushërinjve e kanë bartur trupin e Dautit në shtëpinë e kushëririt Isufit. Një ditë më vonë, Dautin e